

TRASHËGIMIA KULTURORE NË

FO KU S.

TRASHËGIMIA KULTURORE NË SHQIPËRI

TRASHËGIMIA
KULTURORE NË
FO
KU
S.



BOTIMI I TEKSTEVE BURIMORE
MBI PRAKTIKAT E RUAJTJES DHE
MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË
KULTURORE NË GJUHËN SHQIPE

Titulli: “Trashëgimia Kulturore në Fokus: Botimi i teksteve burimore mbi praktikat e ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore në gjuhën shqipe”

Botimi është mundësuar nga “Trashëgimia Kulturore pa Kufij Shqipëri” (Cultural Heritage without Borders Albania (CHwB Albania) me mbështetjen financiare të Suedisë nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim.

Përkthimet nga origjinali: Të ndryshëm referuar në çdo dokument përkatësisht

Redaktoi: Boiken Abazi

Parathënie për botimin nga: Elena Mamani, Lorenc Bejko dhe Boiken Abazi

Koordinoi procesin e përkthimeve dhe publikimit:

Elena Mamani, Regina Vathi, Pezana Rexha

Foto: © Bjori Thana, Regina Vathi

Dizajni: Ina (Hina) Shkëmbi, Joniz Osmanagaj

© CHwB Albania © ICOMOS Albania

Viti i botimit: 2023

196 f.: me foto ; 21 x 21 cm

ISBN: 9789928801081

1.Pasuria kulturore 2.Ruajtja dhe restaurimi 3.Menaxhimi 4.Shqipëri

904 :72 .03(496.5)

Shtëpia Botuese: “Graphic Line-01”



This work is distributed under the Creative Commons BY-NC-ND 4.0 licence, which enables re-users to copy and distribute the material in any medium or format in non-adapted form only, for non-commercial purposes only, and only so long as attribution is given to the creator.

Ky botim publikohet bazuar në licencën nga “Creative Commons BY-NC-ND 4.0”, e cila u mundëson ripërdoruesve të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin në çdo mënyrë komunikimi ose format, por vetëm duke mos kryer përshtatje të formës, duke mos e përdorur për qëllime tregtare, si dhe për aq kohë sa i jepet krijuesit atributi përkatës.

UDHËZUES PËR EDUKIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË KONSERVIMIN E MONUMENTEVE, ANSAMBLEVE DHE SITEVE

Asambleja e Përgjithshme e Këshillit Ndërkombëtar të Monumenteve dhe Siteve, ICOMOS, mbledhja në Kolombo, Sri Lankë, në seancën e saj të dhjetë nga 30 korriku e deri më 7 gusht, 1993.

ICOMOS

Përkthyer nga: Lorenc Bejko.
Redaktuar nga: Boiken Abazi.

Versioni origjinal ©ICOMOS. Ky përkthim nuk është përkthim zyrtar ICOMOS-it. Ky përkthim në gjuhën shqipe botohet me lejen e ICOMOS-it, por nën përgjegjësinë e vetme të përkthyesit/botuesit.

Duke marrë parasysh gamën e shtrirjes së konceptit të monumenteve, ansambleve dhe siteve;

Duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e veprimeve dhe të trajtimeve të nevojshme për konservimin e këtyre burimeve të trashëgimisë, dhe nevojën për një disiplinë të përbashkët për drejtimin e tyre;

Duke qenë të vetëdijshëm se profesionet e ndryshme duhet të bashkëpunojnë brenda një discipline të përbashkët në kuadër të procesit të konservimit, e cila kërkon edukimin e përshtatshëm dhe formimin profesional përmes kurseve të posaçme për të garantuar komunikimin e mirë dhe veprime të koordinuara gjate procesit të konservimit;

Duke theksuar Kartën e Venecias dhe doktrinat e tjera të ICOMOS-it që lidhen me të, dhe nevojën për të siguruar një referencë për institucionet dhe organet e përfshira në zhvillimin e programeve të kurseve të formimit profesional, si dhe për të ndihmuar në përcaktimin dhe ndërtimin e standardeve të duhura dhe kriterëve të përshtatshme për t'i përmbushur kërkesat specifike kulturore dhe teknike të secilit komunitet dhe rajon;

Adopton udhëzuesin e mëposhtëm dhe Rekomandon që ai të shpërndalet për të informuar institucionet, organizatat dhe autoritetet që kanë lidhje me të.

QËLLIMI I UDHËZUESIT

1. Qëllimi i këtij dokumenti është që të japë një shtysë drejt themelimit të standardeve dhe udhëzimeve për edukimin dhe kurset e formimit profesional në konservimin e monumenteve, grupeve të ndërtesave (ansambleve) dhe siteve të përcaktuara si trashëgimi kulturore në bazë të Konventës së Trashëgimisë Botërore të vitit 1972. Ato përfshijnë ndërtesat historike, zonat historiko-urbane dhe qytetet historike, sitet arkeologjike dhe përmbajtjet e tyre, si dhe peizazhet historiko-kulturore. Konservimi është dhe do të vazhdojë të mbetet një çështje urgjente.

KONSERVIMI

2. Konservimi i trashëgimisë kulturore tanimë konsiderohet si një pjesë e fushës më të gjerë të zhvillimit të ambientit dhe kulturës. Strategjitë e menaxhimit të qëndrueshëm të ndryshimeve të cilat respektojnë trashëgiminë kulturore kërkojnë integrimin e qëndrimeve të konservimit me objektivat bashkëkohore ekonomike e shoqërore, përfshi këtu

edhe turizmin.

3. Objekti i konservimit është të zgjasë jetën e trashëgimisë kulturore, dhe nëse është e mundur edhe të qartësojë mesazhin artistik dhe historik brenda saj pa humbur autenticitetin dhe domethënien e saj. Konservimi është aktivitet kulturor, historik, teknik si dhe profesion i bazuar në studime shoqërore dhe shkencore si dhe në hulumtimin sistematik. Konservimi duhet të respektojë kontekstin kulturor.

PROGRAMET DHE KURSET EDUKATIVE DHE ATO TË FORMIMIT PROFESIONAL

4. Ekziston nevoja për të zhvilluar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj trashëgimisë sonë në bazë të pluralizmit dhe larmisë kulturore. Kjo qasje duhet respektuar nga profesionistët, mjeshtrit artizanë dhe administratorët. Konservimi kërkon aftësi vëzhguese, analitike dhe sintetizuese. Konservuesi duhet të ketë një qasje të lakueshme por pragmatike të bazuar mbi ndërgjegjësimin kulturor i cili duhet të mbizotërojë në të gjitha punët në praktikë, edukimin dhe formimin e përshtatshëm. Për më tepër, konservimi kërkon edhe aftësi të mira vendimmarrëse dhe një kuptim mbi raportet duke kuptuar mirë edhe nevojat e komunitetit. Në këtë aktivitet shumëdisiplinor ka nevojë për shumë aftësi profesionale dhe profesione të ndryshme.
5. Punët e konservimit duhet t'u besohen vetëm atyre personave që janë kompetentë në këto aktivitete të specializuara. Edukimi dhe formimi profesional duhet të ketë si rezultat formimin e një sërë profesionistësh dhe konservuesish që janë në gjendje:
 - e. të kuptojnë një monument, ansambël apo sit dhe të identifikojnë rëndësinë emocionale, kulturore dhe funksionale;
 - f. të kuptojnë historinë dhe teknologjinë e monumenteve, ansambleve dhe siteve në mënyrë që të përcaktojnë identitetin e tyre, planin e konservimit si dhe të interpretojnë rezultatet e hulumtimit të tyre;
 - g. të kuptojnë ambientin e monumentit, ansamblit apo sitit, përmbajtjen dhe rrethinat e tyre në lidhje me ndërtesat, kopshtet apo peizazhet e tjera;
 - h. të gjejnë dhe të kuptojnë të gjitha burimet e

mundshme të informacionit që kanë lidhje me monumentin, ansamblin apo sitin që po studiohet;

- i. të kuptojnë dhe të analizojnë sjelljen e monumenteve, ansambleve dhe siteve si sisteme komplekse;
- j. të diagnostikojë shkaqet e brendshme dhe të jashtme të prishjes si baza për të identifikuar veprimet e nevojshme;
- k. të inspektojnë dhe përgatisin raporte të kuptueshme edhe për lexues që nuk janë specialistë lidhur me monumentet, ansamblet apo sitet, duke përdorur ilustrime grafike përmes skicave ose fotografive;
- l. të njohin, të kuptojnë dhe të aplikojnë konventat dhe rekomandimet e UNESCO-s dhe ICOMOS-it si dhe kartat, rregulloret dhe udhëzuesit e tjerë të njohur;
- m. të marrin vendime të ekuilibruara të bazuara në parime të përbashkëta etike si dhe të pranojnë përgjegjësinë për mbarëvajtjen afatgjatë të trashëgimisë kulturore;
- n. të dinë kur duhet kërkuar këshillë dhe kur duhen përcaktuar fushat që duhet të studiohen nga specialistë të ndryshëm, si p.sh. pikturat murale, skulpturat dhe objektet me vlera artistike dhe historike, dhe/ose studime të materialeve dhe sistemeve;
- o. të japin këshilla me ekspertizë rreth strategjive të mirëmbajtjes, politikave të menaxhimit dhe kuadrit të politikave për mbrojtjen ambientale dhe ruajtjen e monumenteve dhe përmbajtjes së tyre, si dhe të siteve;
- p. të dokumentojnë punimet e zbatuara dhe të kujdesen që ato të jenë të vizitueshme nga publiku;
- q. të punojnë në grupe të përbëra nga profesionistë të disiplinave të ndryshme, duke përdorur metoda të përshtatshme;
- r. të punojnë me banorët, administratorët dhe planifikuesit për të zgjidhur konfliktet si dhe të zhvillojnë strategji të konservimit të përshtatshme për nevojat, aftësitë dhe burimet vendore;

QËLLIMET E KURSEVE

6. Ekziston nevoja për t'i përcuar njohuritë e qëndrimeve dhe qasjeve të konservimit të gjithë ata të cilët mund të kenë një ndikim direkt apo indirekt në pronat kulturore.
7. Praktika e konservimit është e shtrirë në shumë fusha, dhe rrjedhimisht edhe temat e kurseve duhet të përfshijnë fusha të ndryshme. Profesionistëve, duke përfshirë edhe akademikët dhe mjeshtrit artizanë të specializuar që kanë kryer kualifikimin e tyre të zakonshëm, do t'u nevojiten kualifikime të mëtejshme për t'u bërë konservues. E njëjta gjë vlen edhe për ata të cilët duan të punojnë vetëm brenda një ambienti historik.
8. Konservuesit duhet të sigurohen që të gjithë artizanët dhe punonjësit e një monumenti, ansambli apo siti të respektojnë vlerat dhe rëndësinë e këtyre të fundit.
9. Kurset përgatitore duhet të përfshijnë kualifikimin mbi gatishmërinë në rastin e një fatkeqësie dhe mbi metodat e zbutjes së dëmeve mbi pronën kulturore, përmes përforsimit dhe përmirësimit të parandalimit të zjarrit dhe masave të tjera të sigurisë.
10. Zanatet tradicionale janë një burim i vlefshëm kulturor. Mjeshtrit artizanë të cilët kanë fituar një nivel të lartë aftësish të punëve me dorë duhet të stërviten më tej në lidhje me punën konservuese me udhëzimet mbi historinë e zanatit të tyre, detajet dhe praktikat historike, si dhe mbi teorinë e konservimit dhe nevojën për dokumentim. Shumë aftësi historike duhet të regjistrohen dhe të ringjallen.

ORGANIZIMI I EDUKIMIT DHE I KURSIT TË FORMIMIT PROFESIONAL

11. Ekzistojnë shumë metoda të pranueshme për të arritur edukimin dhe formimin e duhur. Variantet e ndryshme do të varen nga traditat dhe legjislacioni, si dhe nga konteksti administrativ dhe ekonomik i secilit rajon kulturor. Në nivel ndërkombëtar, duhet inkurajuar shkëmbimi aktiv i ideve dhe i mendimeve rreth qasjeve të reja në edukim dhe formim profesional mes institucioneve kombëtare të vendeve të ndryshme. Rrjeti i bashkëpunimit mes individëve dhe institucioneve është diçka thelbësore në suksesin e këtij shkëmbimi.
12. Edukimi dhe sensibilizimi mbi konservimin duhet të fillojë në shkolla dhe të vazhdojë më tej në

universitete e më gjerë. Këto institucione kanë një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit pamor dhe kulturor, duke përmirësuar aftësinë për të lexuar dhe kuptuar elementet e trashëgimisë sonë kulturore, si dhe duke ofruar përgatitjen e duhur kulturore të kandidatëve për një kurs formimi profesional apo të një edukimi të specializuar. Për profesionet e ndryshme duhet inkurajuar ushtrimi në praktikë.

13. Kurset për zhvillimin e vazhdueshëm profesional mund të përmirësojnë edukimin dhe stërvitjen fillestare të profesionistëve. Kurset afatgjata me kohë të pjeshme janë një metodë e mirë për të marrë njohuri të avancuara, dhe një metodë e tillë është mjaft e dobishme në qendrat me një numër të madh popullsie. Kurset e shkurta mund t'i pasurojnë profesionistët me këndvështrime të ndryshme, por ato nuk mund t'u mësojnë atyre aftësi apo të mundësojnë kuptimin e mirëfilltë të konservimit. Ato mund të ndihmojnë në prezantimin me konceptet dhe teknikat e konservimit në menaxhimin e ambientit të ndërtuar dhe të atij natyror, si dhe të objekteve brenda tij.
14. Pjesëmarrësit në kurset e specializuara duhet të jenë të kalibrit të lartë, zakonisht duke pasur përvojë në punë praktike të ndërtuar me edukimin dhe stërvitjen e përshtatshme. Kurset e specializuara duhet të mbulojnë tema në shumë disiplina duke prezantuar edhe lëndët bazë për të gjithë pjesëmarrësit, si dhe duke ofruar lëndë me zgjedhje për të rritur kapacitetet dhe/apo për të mbushur boshllëqet e edukimit dhe stërvitjes së mëparshme. Në mënyrë që të plotësohet edukimi dhe stërvitja e konservuesit është e rekomandueshme që të kryhen stazhe të ndryshme për t'i mundësuar pjesëmarrësve përvojë praktike në terren.
15. Secili shtet apo grup rajonal duhet të inkurajohet që të ndërtojë të paktën një institut të organizuar në mënyrë gjithëpërfshirëse i cili ofron edukimin, stërvitjen dhe kurse të specializuara. Mund të nevojiten dekada të tëra për të vendosur një shërbim konservimi plotësisht kompetent. Si pasojë, mund të nevojiten masa të posaçme afatshkurtra, duke përfshirë edhe integrimin e nismave të reja në programet ekzistuese, në mënyrë që të arrihet deri aty sa të krijohen programe të reja të kompletuara në të gjitha aspektet. Duhet inkurajuar shkëmbimi i mësuesve, ekspertëve dhe

studentëve brenda vendit, në nivel rajonal, dhe në nivel ndërkombëtar.

BURIMET

16. Burimet e nevojshme për kurset e specializuara mund të përfshijnë:
 - a. një numër të përshtatshëm pjesëmarrësish të nivelit të duhur, dhe teorikisht të grupmoshës 15 deri 25 vjeç;
 - b. një koordinator të përhershëm të cilit i jepet edhe mbështetja e përshtatshme administrative;
 - c. instruktorë me njohuri me baza të forta teorike dhe përvojë praktike në fushën konservimit, si dhe me aftësi pedagogjike;
 - d. hapësira të pajisura mirë, të cilat përfshijnë hapësirat për të mbajtur leksione me pajisje audio-vizuale, video, studio, laboratorë, reparte për punën me dorë, dhoma për seminare dhe zyra për stafin;
 - e. biblioteka dhe qendra dokumentimi që përmbajnë referenca për koleksione të ndryshme, hapësira për një punë kërkimore të koordinuar, dhe qasje në rrjete informacioni të kompjuterizuara;
 - f. një sërë monumentesh, ansamblesh dhe shtes brenda një rrezeje të arsyeshme.
17. Konservimi varet nga dokumentimi i përshtatshëm për të kuptuar monumentet, ansamblet apo shtet dhe ambientin e tyre përkatës. Çdo shtet duhet të ketë një institut për të kryer hulumtimin dhe një arkiv për regjistrimin e trashëgimisë kulturore dhe të të gjitha punimeve konservuese të kryera mbi këtë trashëgimi. Kursi duhet të zhvillohet brenda përgjegjësive të arkivit të identifikuar në nivel kombëtar.
7. Financimi i pagesave dhe i bursave për studim mund të kërkojë një mbështetje të veçantë për pjesëmarrësit që janë në mes të karrierës së tyre, pasi ata mund të kenë edhe detyrime personale.